

L I G J

Nr.8528, datë 23.9.1999

PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E TË USHQYERIT ME GJI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pikë 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Ky ligji ka për qëllim të nxitë dhe të mbrojë të ushqyerit me gji, si dhe të rregullojë tregtimin e zëvendësuesve të qumështit të gjirit për të ushqyerit e shëndetshëm të fëmijëve.

Neni 2

Në zbatim të këtij ligji, termat vijues kanë këto kuptime:

a) "Reklama" kuptohet reklamimi me çdo mjet për nxitjen, shitjen ose për konsumin e prodhimeve të zëvendësuesve të qumështit të gjirit.

b) "Ushqim plotësues" kuptohet çdo ushqim i përshtatshëm, i paraqitur për ushqim shtesë të qumështit të gjirit, formula përfshirë foshnjën ose formulën pasuese.

c) "Mbajtëse" kuptohet çdo formë paketimi i produktit të përcaktuar për shitje si një njësi për shitje me pakicë, duke përfshirë edhe ambalazhin.

ç) "Produkt i përcaktuar për shitje" kuptohet :

- Formulë përfshirë foshnjat, e cila nënkuption qumështin ose një produkt të ngjashëm me qumështin, me origjinë shtazore ose bimore, i përgatitur industrialisht, që tregtohet për ushqimin e foshnjave dhe të fëmijëve të vegjël, nga lindja deri në gjashtë muaj.

- Formulë pasuese, e cila nënkupton qumështin ose një produkt të ngjashëm me qumështin, me origjinë shtazore ose bimore, i përgatitur industrialisht, që tregtohet si ushqim përfshirë foshnjat dhe fëmijët mbi gjashtë muajsh.

- Çdo produkt tjetër, i shitur për ushqimin e foshnjave dhe të fëmijëve të vegjël.

d) "Foshnjë" kuptohet një fëmijë nga dita e lindjes deri në 12 muaj.

dh) "Fëmijë i vogël" kuptohet një fëmijë nga mosha në 12 muaj deri 3 vjeç.

Kufizimet

Neni 3

Asnjë person nuk duhet të prodhojë, të shpërndajë, të shesë, të magazinojë ose të

ekspozojë për shitje produkte të përcaktuara në nenin 2 pika ç të këtij ligji, kur ato:

- nuk janë të regjistruala në përputhje me ligjet në fuqi;
- kanë arritur datën e skadimit;
- nuk janë në mbajtëset e tyre origjinale.

Neni 4

Prodhuesve dhe shitësve u ndalohet reklama dhe promovimi i produkteve të përcaktuara në nenin 2 pika ç, duke përfshirë këtu paraqitjen speciale, vizuale në ekrane, reklamat për ulje çmimi, çmimet stimuluese, shitjet speciale, ulje çmimi me kushte të veçanta apo dhurata, si dhe promovimi i tyre në një qendër shëndetësore apo institucion tjetër të sistemit shëndetësor shtetëror ose privat.

Neni 5

Ndalohet një prodhues ose një person i ngarkuar nga ai, si dhe çdo shitës:

- a) t'u shesë institucioneve shëndetësore shtetërore dhe private produktet e përcaktuara në nenin 2 pika ç, me çmim më të ulët se çmimet e publikuara nga prodhuesit;
- b) të dhurojë ose të shpérndajë, brenda një qendre shëndetësore, pajisje ose të ofrojë shërbime, si dhe materiale promovuese, që u referohen ose mund të nxisin përdorimin e një produkti, të përcaktuar sipas nenit 2 pika ç, me përjashtim të rasteve kur kategorizohen si ndihma humanitare;
- c) t'u ofrojë shpérblime, dhurata, kontribute punonjësve të shëndetësisë, të angazhuar me shëndetin e nënës dhe të fëmijës;
- c) të sponsorizoju veprimtari, pavarësisht nga forma e tyre, që lidhen me shëndetin e nënës dhe të fëmijës, përjashtuar veprimtaritë me karakter të mirëfilltë shkencor.

Neni 6

Çdo punonjësi të shëndetësisë, që punon në institucionet shëndetësore shtetërore dhe/ose private, i ndalohet:

- a) të pranojë shpérblime, dhurata, kontribute nga një prodhues, shpérndarës ose çdri person tjetër i ngarkuar prej tyre;
- b) të pranojë ose të shpérndajë monstra të këtyre produkteve;
- c) të promovojojë përdorimin e produkteve të përcaktuara në nenin 2 pika ç, përjashtuar rastet e veçanta, kur ka tregues absolut për përdorimin e tyre, duke shpjeguar qartë edhe pasojat që sjellin ato.

Kufizimet e lidhura me etiketat e formulave foshnjore

Neni 7

Një prodhues, shpérndarës ose shitës nuk duhet të ofrojë për shitje ose të shesë formula pasuese, në qoftë se ambalazhi ose etiketa nuk përmban formulimin:

“Ushqimi i gjirit është ushqimi ideal për rritjen e shëndetshme dhe për zhvillimin e fëmijëve. KUJDES! Ky produkt do të përdoret për foshnjat nën 6 muajshe. Përpara se

“të vendosësh të plotësosh ose të zëvendësosh ushqimin e gjirit me këtë produkt, këshillohu me mjekun!”

Neni 8

Një prodhues, shpérndarës ose shitës nuk duhet të ofrojë për shitje ose të shesë formula pasuese, në qoftë se :

a) ambalazhi ose etiketa nuk përmban fjalët :

“Ushqimi i gjirit është ushqimi ideal për rritjen e shëndetshme dhe për zhvillimin e fëmijëve. KUJDES! Ky produkt do të përdoret për foshnjat mbi 6 muajshe. Përpara se të vendosësh të plotësosh ose të zëvendësosh ushqimin e gjirit me këtë produkt, këshillohu me mjekun!”;

b) etiketa nxit të ushqyerit artificial.

Neni 9

Një prodhues ose shpérndarës nuk duhet të ofrojë për shitje ose të shesë qumësht të skremuar apo të kondensuar në formë pluhuri ose të lëngët, apo qumësht standard e të skremuar si zëvendësues të qumështit të gjirit.

Në ambalazhin e këtyre produkteve duhet detyrimisht të shkruhet:

“Ky produkt nuk duhet të përdoret për ushqimin e foshnjave!”

Detyrat e sistemit shëndetësor

Neni 10

Drejtuesit e qendrave shëndetësore dhe autoritetet shëndetësore, vendore dhe kombëtare, duhet të nxisin, të mbështesin dhe të mbrojnë, në kuptim të këtij ligji, të ushqyerit me gji dhe të bëjnë publike mangësitë e mëdha që krijojnë të ushqyerit alternativ.

Neni 11

Materialet informative apo me qëllim edukimi dhe promocioni të jenë, detyrimisht, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë apo nga strukturat përkatëse të ngritura ose të autorizuara prej saj.

Neni 12

Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji.

Ngarkohet Inspektorati Sanitar Shtetëror për kontrollin dhe për zbatimin e këtij ligji.

Kundërvajtjet

Neni 13

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk formojnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje